

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare - Konferencë Kombëtare
“SFIDAT E ZHVILLIMIT TË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJEN
E AMF-SË DHE EDUKIMI FINANCIAR”
24 Maj 2018 - Tiranë, Shqipëri

TREGU I PENSIONEVE PRIVATE VULLNETARE

Sonila Stasa¹
Meriban Vraja²

Abstrakt

Fondi i pensionit vullnetar është pjesë e njohur e sistemit ndërkombëtar të pensioneve. Ky pension është krijuar pasi sistemet e zakonshme, shtetërore të pensioneve nuk i sigurojnë njerëzve të ardhura të mjaftueshme kur arrijnë moshën e pensionit. Sigurimet private, si skemë efikase, e ndërthurur edhe me sigurimet shoqërore, janë krijuar me synimin për të financuar të ardhurat në moshën e pensionit.

Sipas ligjit nr. 10197 për “Fondet e pensionit vullnetar” planet e pensionit ndahen në: (i) “Plan pensioni” është kontrata ndërmjet individit dhe shoqërisë administruese, për ofrimin e përfitimeve për pension. Shërbimet e fondit të pensionit, të krijuar nga shoqëria administruese, i ofrohen individit, i cili, me pëlqimin e vet, bëhet anëtar i fondit të pensionit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji; si edhe (ii) “Plan pensioni profesional” është kontrata ndërmjet punëdhënësit dhe shoqërisë administruese, për ofrimin e përfitimeve për pension. Shërbimet e fondit të pensionit, të krijuar nga shoqëria administruese, i ofrohen punëmarrësit, i cili, me pëlqimin e vet, bëhet anëtar i fondit të pensionit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Skema aktuale e pensioneve shtetërore të Shqipërisë vuan nga një deficit i thellë. Kështu, ajo ofron përfitime të ulëta për individët kur ata arrijnë moshën e pensionit. Një sistem kombëtar i pensioneve nuk vepron i izoluar nga ekonomia e një vendi. Në fakt është një nënsistem i rëndësishëm socio-ekonomik dhe politik, i cili bashkëvepron me aktorë të tjerë të ekonomisë kombëtare dhe globale. Rritja e qëndrueshme ekonomike dhe nivelet e larta të punësimit nxisin një mjedis të përshtatshëm për sistemet e pensioneve. Është e domosdoshme që politika e pensioneve të krijojë një sinergji pozitive me politikat e tregut të punës, politikat fiskale dhe makroekonomike dhe politikat e mbrojtjes sociale, si pjesë e një politike kombëtare të integruar.

Fjalë kyçe: *pension vullnetar, treg, ekonomi, politika fiskale, mbrojtje sociale, integrim.*

¹ Viti i I-rë Financë-Bankë “ALBANIAN UNIVERSITY” sonilastasa2@gmail.com

² Viti i I-rë Financë-Bankë “ALBANIAN UNIVERSITY” meribanvraja123@gmail.com